

**Data 10.03.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Furnizime dhe shërbime me ushqim për mencent dhe qendrat komunitare**

**Vezë 875,122.5** (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzetë e dy presje pesë ) lekë pa tvsh

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Produkte ushqimore të ndryshme 15800000-6**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Vezë 875,122.5** (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzetë e dy presje pesë ) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gjirokastrë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit
- c. Formulari i ofertes

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....  
(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, , në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke*

*iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

***Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.***

***Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.***

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.***

Operatori ekonomik duhet të disponojë Liçencë, kategoria II.1.A.1 - “Prodhim, përpunim, dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër ekonomik. Në rastet kur operatorët ekonomikë nuk kanë detyrim ligjor të liçencohen nga QKB, duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti i prokurimit në fjale

**Argumentim:**

*Ky kriter është vendosur bazuar në rekomandimin e përbashkët të APP dhe të AKU me nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “ Mbi Hartimin e kriterëve të Vecanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, III.Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim pika a dhe b.*

*Ky kriter është në përputhje me vlerën dhe objektin e kontratës dhe shërben për të siguruar një cilësi të mirë të ushqimeve për grupet e vecanta të konsumatorëve nën kujdesin dhe përgjegjësinë e bashkësive sic janë familjet.*

2.3.2 Operatori ekonomik të jete i paisur me Certificate të sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.

**Argumentim:**

*Ky kriter është vendosur bazuar në rekomandimin e përbashkët të APP dhe të AKU me nr .10181 prot, datë 19.11.2018 “ Mbi Hartimin e kriterëve të Vecanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, III.Hartimi i kriterëve të vecanta për kualifikim pika e.*

*Kërkesat e mesipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m<sup>2</sup>, për të cilin duhet të paraqes dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë noteriale huapërdorje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë noteriale qiraje.

b) Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient,

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për këtë ambient.

d) Foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi.

***Argumentim:***

***Ky kriter është vendosur bazuar ne rekomandimin e përbashkët të APP dhe të AKU me nr .10181 prot, datë 19.11.2018 “ Mbi Hartimin e kriterëve të Vecanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, III.Hartimi i kriterëve te vecanta per kualifikim pika e.***

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (nje) automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer), me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t'i ketë në pronësi ose me qira, dhe për të cilët duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit;

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;

e) Certificate për transport mallrash

f) Akt miratimi higjeno – sanitar;

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit*

**Argumentim:**

***Ky kriter është vendosur bazuar ne rekomandimin e përbashkët të APP dhe të AKU me nr .10181 prot, datë 19.11.2018 “ Mbi Hartimin e kriterëve të Vecanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, III.Hartimi i kriterëve te vecanta per kualifikim pika e.***

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te operoje duke plotesuar standartet ne fuqi per sigurine ushqimore. Per kete, ai duhet te paraqese vetdeklarim, ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konforme kerkesave ligjore. Ndersa, operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin të paraqes dokumentacion provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore).

**Argumentim:**

***Ky kriter është vendosur bazuar ne rekomandimin e përbashkët të APP dhe të AKU me nr .10181 prot, datë 19.11.2018 “ Mbi Hartimin e kriterëve të Vecanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, III.Hartimi i kriterëve te vecanta per kualifikim pika e.***

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit.

**Argumentim:**

***Ky kriter është kërkuar për të siguruar lëvrim të mallit të shpejtë dhe në cdo kohë pranë magazines te drejtorise se arsimit, per te mundesuar ne kohe per gatitjen e vakteve per femijet.***

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**Sqarim**

AK për të bërë sa më të thjeshtë procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për anëtarët e organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit aksionerit ose ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese , vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik këkon nga ana e operatorëve ekonomik për të deklaruar ID e personave të cilët do të deklarohen në Shtojcën 9 të Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit për këtë verifikim

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**NJËSI E PROKURIMIT**

**Marsela Shametaj**

**Alma Llaca**

**Lorjana Shehu**